

INTERVISTA E KRYETARIT TË PREZENCËS ME TV ORA NEWS

Drejtëpërsëdrejti në 'Tonight me Ilva Tare', 24 Maj

Pyetje: Prezanton dhe i uron mirëseardhjen Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në programin "Tonight". Cilat ishin përshtypjet tuaja të para kur mbërritët në Tiranë?

Mendova se është misioni më interesant dhe më i rëndësishëm që të ndihmoja Shqipërinë për të përmbushur angazhimet e saj ndërkombëtare. Menjëherë më pëlqeu puna me shqiptarët. Ajo çka më pëlqeu kur erdha këtu ishte optimizmi në fytyrat e njerëzve – sidomos tek njerëzit e zakonshëm dhe kjo të bën të mendosh se ia vlen t'i ndihmosh të ecin përpara në të gjitha nivelet. E kam fjalën sigurisht për zyrtarët e niveleve politike, punën me partitë, punën me udhëheqësit e partive politike, punën me deputetët, si dhe punën me njerëzit e interesuar në politikë, por që nuk janë vetë politikanë, si anëtarët e shoqërisë civile. Kështu që m'u duk se isha në vendin e duhur dhe kam një detyrë shumë interesante dhe shumë të rëndësishme këtu në Tiranë dhe në pjesë të tjera të Shqipërisë.

Pyetje: A ju ka ndihmuar puna e mëparshme në Kosovë/UNMiK për ta njohur më mirë mjedisin shqiptar?

Patjetër që më ka ndihmuar koha që kam punuar atje, të cilën nuk dua ta quaj si periudha e "nxehjes", sepse janë dy mjedise të ndryshme. Gjatë 100 vjetëve të fundit, historia e Kosovës ka qenë shumë më e ndryshme nga historia e Shqipërisë. Shqipëria ka pasur privilegjin e të qenit një vend sovran. Kosova ka një histori shumë të veçantë dhe kjo, sigurisht, përfshin një numër të madh shqiptarësh nga Kosova. Puna me ta, puna me njerëzit e zakonshëm dhe me politikanët, më ka ndihmuar edhe më shumë. Unë kisha punuar më parë që nga Beogradi në Ish-Jugosllavi duke mbuluar edhe çështje që kishin lidhje me Kosovën, por jo aq shumë. E kam fjalën për vitet 1991-92, kur të tjera gjëra ishin më të ngutshme. Pra, koha në Kosovë ishte shumë interesante. Ne arritëm të ruanim një atmosferë paqësore pjesën më të madhe të kohës, në mënyrë që njerëzit të jetonin në kushte më paqësore e më të qeta. Kjo, do të thosha, ndihmon sigurisht për të kuptuar një pjesë të mentalitetit.

Pyetje: Cilat janë angazhimet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri sipas mandatit të saj, i cili skadon më 31 dhjetor 2011?

Po, mandati është një-vjeçar. Çdo mision e merr mandatin përmes një vendimi të marrë nga vendet anëtare që mblidhen në Këshillin e Përhershëm në Vjenë mbi bazën e angazhimeve që ka marrë përsipër çdo vend pjesëmarrës. Shqipëria është një prej tyre, pra një prej 56 vendeve anëtare që shtrihen nga Vankuveri deri në Vladivostok, duke përfshirë kështu të gjitha kombet në veri të globit. Këto angazhime fillojnë me demokratizimin, shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut, si dhe me një sërë çështjesh që i bëjnë demokracitë, që i bëjnë njerëzit të jetojnë në një mjedis të mirë, të shëndetshëm, të sigurt e mundësisht edhe të begatë, dhe t'i shohësh ata t'i përmbushin këto angazhime.

Pyetje: Cilat janë arsyet që e detyrojnë OSBE-në të vazhdojë të qëndrojë këtu pak a shumë përgjithmonë?

Rruga që Shqipëria ka marrë drejt integritimit evropian dhe angazhimet drejt vendeve anëtare të OSBE-së, si dhe nevoja për t'iu afruar standardeve të BE-së, ku demokratizimi dhe shteti i së drejtës janë parakushte dhe janë të nevojshëm edhe për të qenë anëtare e NATO-s më të drejta të plota.

Pyetje: Sa e vështirë është t'i promovosh këto vlera në një mjedis ku tensioni politik është kaq i lartë sa këtu në Shqipëri?

Interesi i njerëzve dhe i publikut në përgjithësi është relativisht i madh, disa nga detyrat tona janë mjaft teknike, kurse disa të tjera jo. Disa nga projektet tona kanë gjithashtu për qëllim të tregojnë edhe se sa rol të rëndësishëm luajnë gratë në shoqëri. Çdo shoqëri përbëhet nga burra dhe gra që punojnë së bashku, duke bashkëpunuar për një shoqëri më të mirë dhe në këtë rast, gratë për shembull e kryejnë punën e tyre përmes ideve që ato japin.

Pyetje: Pra, nuk ka qenë e vështirë, nuk jeni ndeshur me vështirësi?

Jo, më pëlqen puna këtu. Sigurisht që më momente të veçanta ka edhe sfida, por ne duhet të shohim gjithmonë tablonë e qartë, duke punuar me të gjitha pjesët e shoqërisë e duke punuar me të gjitha pjesët e spektrit politik. Kjo kërkon energji, por në kuptimin më të gjerë, kjo është shumë e rëndësishme për njerëzimin dhe në këtë rast për Shqipërinë. Puna me shqiptarët të jep edhe mjaft kënaqësi dhe mund t'ju them arsyen. Njerëzit këtu mësojnë shpejt. Ndonjëherë habitem se si edhe njerëz që nuk kanë pasur shumë mundësi të arsimohen, flasin gjuhë të huaja shumë rrjedhshëm. Gjera të tilla më lënë mbresa dhe kjo është diçka e mirë dhe inkurajuese.

Pyetje: A jeni i kënaqur me nivelin e zbatimit të reformave që ka ndërmarrë organizata juaj?

Po, jam i kënaqur me disa prej tyre. Megjithatë, mendoj se disa nga ato më komplekset, që kërkojnë zhvillime të thella në legjislacion dhe punë të përbashkët në parlament aktualisht kanë mbetur në vend për shkak të situatës që kam gjetur këtu kur kam mbërritur në Shqipëri në muajin shtator vitin e kaluar. Ajo çka i duhet këtij kombi në këtë fazë është një parlament që funksionon plotësisht me më shumë konsensus përtej kufijve të partive politike e që do ta bënte opozitën plotësisht pjesë të procesit ligjvënës. Në momente të caktuara, kur vjen puna tek legjislacioni i mirë, kjo është shumë e rëndësishme për axhendën e reformave.

Pyetje: A ekzistojnë rregullat për zbatimin e këtij legjislacioni dhe a janë ato të zbatueshme?

Shumica e tyre ekzistojnë, ju keni Kushtetutën. Ju keni një bazë të mirë, por jo të plotë. Kështu për shembull, ju mungojnë gjykatat administrative, por një pjesë e mirë e legjislacionit ekziston. Kjo lidhet deri në njëfarë mase edhe me trajnimin e zyrtarëve dhe të nëpunësve civilë në aspekte të caktuara në mënyrë që ata t'i zbatojnë ligjet dhe rregulloret sa më mirë që të jetë e mundur. Kjo kërkon shumë eksperiencë, kërkon një vullnet të mirë për zhvillimin e tyre përmes trajnimit në mënyrë konsensuale dhe kjo është pjesë e punës sonë. Kjo është një notë mjaft e mirë, sepse e rëndësishme është që përpjekjet ia vlejnjë. Nuk dua ta pikturoj gjithçka rozë, por ky komb ka pasur një fillim të vështirë pas 50 vjetësh nën regjimin e ashpër të Hoxhës dhe ndryshimi i asaj situatë për 20 vjet është një proces jashtëzakonisht i madh. Më lejoni të bëj një krahasim në kohë; unë jam diplomat gjerman dhe jam rritur në Gjermani. Edhe bashkimi ynë ndodhi pak a shumë në të njëjtën kohë që filluan edhe proceset demokratike këtu në Shqipëri. Njerëzve u duhet ende kohë që të mësohen me këtë. E njëjta gjë vlen edhe për Shqipërinë. Duhet durim. Duhet njëkohësisht edhe padurim për t'i çuar gjërat përpara. Megjithatë, dita e zgjedhjeve ishte e qetë. Shumë njerëz, një pjesë e madhe e popullsisë, dhe mendoj se kjo është shumë mbresëlënëse, morën pjesë në zgjedhje dhe i hodhën votat në mënyrë paqësore. Pra, që ta bësh demokracinë të funksionojë duhet kohë, por është e arritshme. Kjo është pjesë e punës sonë.

Pyetje: Ju kuptoj, ashtu siç kuptoj edhe padurimin e shqiptarëve, sepse jeta është e shkurtër. Prandaj edhe shqiptarëve duket se po u humbet durimi përballë papjekurisë së institucioneve dhe performancës së tyre të dyshimtë. A janë institucionet shqiptare të pavarura dhe a punojnë ato në përputhje me standardet dhe kriteret e OSBE-së?

Kjo është pyetje delikate, dhe unë nuk mund të them prerazi as 'Po', as 'Jo'. Më lejoni të them se institucionet janë mjaft të mira. Është shuam e rëndësishme, sigurisht, që çdo zyrtar dhe çdo

nëpunës civil t'i ofrojë të njëjtin nivel shërbimesh çdo anëtar të shoqërisë. Kjo na çon në faktin se askush nuk duhet të diskriminohet, pavarësisht kushteve të tij personale. Të gjithë duhet të gëzojnë të njëjtin nivel shërbimi. Në disa raste ka vend për përmirësim, ndonjëherë duket sikur shoqëria është e orientuar më shumë se ç'duhet tek familja dhe jo aq shumë te shoqëria dhe gjetja e një ekuilibri midis të dyjave është e rëndësishme. Një shoqëri më e hapur dhe më e drejtë dhe e bazuar tek shteti i së drejtës do të ndihmonte edhe për zhvillimin e demokracisë, pasi origjina familjare e çdo qytetari, të ri apo të vjetër, nuk duhet ta bëjë atë të ndryshëm nga të tjerët.

Pyetje: Ka organizata dhe shoqata që kanë përgjegjësinë e edukimit të publikut në këtë aspekt. A po bëhet ky edukim dhe kush po e bën?

Më lejoni të them se sot media moderne ka një përgjegjësi të madhe për të ofruar informacion. Baza e rëndësishme fillon me një arsim të mirë, është e vërtetë. Nuk dua të bëhem shumë përgjithësues për mënyrën se si duhet 'trajnuar' publiku i gjerë. Megjithatë, për ne, për mandatin tonë, është e rëndësishme të ndihmojmë për shembull shërbimet e policisë, në mënyrë që policia të ofrojë një nivel të lartë profesionalizmi. Kështu, ne kemi ofruar disa trajnime në të kaluarën, si me policinë kufitare, gjendjen civile, dhe një sërë çështjesh të tjera që lidhen me gjendjen civile si me pasaportat, të cilat ndihmuan edhe për procese të tjera si për heqjen e vizave në zonën Shengen. Të gjitha këto janë elemente të shoqërisë civile si dhe pjesë e shërbimit civil në ofrimin e një niveli sa më të mirë e më eficient shërbimesh për të bërë shoqërinë më të qëndrueshme. Pra, është shumë komplekse, shumë intensive në nivele të ndryshme dhe organizata si OSBE-ja fokusohen në disa pjesë të këtij procesi. Pjesët e tjera bëhen nga misionet ndërkombëtare dhe ambasadat. Kjo është një mbështetje e përbashkët për Shqipërinë, e cila jepet nga OSBE-ja, por jo vetëm nga OSBE-ja.

Pyetje: Le të hapim tani, zoti Ambasador, kapitullin apo dosjen e zgjedhjeve. Si preferoni ti quani, kapitull apo dosje?

Si të doni, zgjedhje zhvillohen rregullisht në demokraci, kështu që mund t'i quani si kapitull, ashtu edhe dosje.

Pyetje: A janë adresuar rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të 2009-ës nga partitë politike? Nëse jo, pse dhe kush mban përgjegjësi për këtë?

31 rekomandimet e raportit të OSBE/ODIHR-it të 2009-ës nuk janë adresuar siç duhet. Përpjekja e fundit për të arritur një marrëveshje të mirë u iniciua nga Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Patozi. Në fillim u mirëprit nga të gjitha partitë, pastaj u reduktua në katër parti, nëse më kujtohet mirë. Ishte shprehja e një vullneti të mirë për një fushatë dhe zhvillime të ndershme. Në vjeshtën e vitit të kaluar pati gjithashtu një nismë të mirë nëpërmjet të paktën një tryeze të rrumbullakët, ku morën pjesë kryetarët e të gjitha partive dhe e adresuan këtë çështje. Megjithatë, reforma e Kodit Zgjedhor është sigurisht shumë komplekse dhe ka nevojë për diskutime dhe për reflektime të shëndosha, si dhe për integrimin e një ekspertize të konsiderueshme që mund të vijë nga parlamenti, partitë, apo edhe nga shoqëria civile. Edhe kjo kërkon kohë. Edhe tetori ishte një fillim i vonuar për shkak të zgjedhjeve të planifikuara për t'u zhvilluar më 8 maj 2011. Pra, një arsye ishte koha, kurse tjetra lidhej me situatën pas zgjedhjeve të vitit 2009, e cila ishte e paqartë dhe jo moment i përshtatshëm për vendim-marrje, ndërkohë që bojkotimi i parlamentit përbën vërtet një problem për Shqipërinë, pasi ai është pengesë edhe për procesin e integritetit.

Pyetje: A mendoni se ngërçi politik pas zgjedhjeve të 2009-ës ndikoi në standardet e zgjedhjeve lokale të 2011-ës?

Rekomandimet kishin për qëllim ta bënin procesin më të qetë. Për këto zgjedhje do të ketë një raport nga Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it, i cili do të dalë për dy muaj. Raporti i

shtatorit 2009 dhe rekomandimet e atëhershme mund ta kishin bërë procesin edhe më të qetë nëse do të ishin trajtuar disa prej 31 pikave. Megjithatë, e rëndësishme është që ekziston vullneti i mirë që të gjithë të marrin pjesë në përgatitjen dhe ushtrimin e detyrave të tyre gjatë këtij procesi kompleks, të bëjnë më të mirën dhe të respektojnë rregullat duke bërë punën siç duhet dhe kjo është gjëja më e rëndësishme. Një nga këto pika, që është pikërisht vullneti i mirë dhe besimi tek njëri-tjetri, është një fushë ku duhet të punojmë më shumë.

Pyetje: A ka aktualisht besim mes palëve?

Unë u besoj palëve. Nuk është ky problemi. E rëndësishme në Shqipëri është që palët të kenë besim tek njëra-tjetra. Kjo është shumë më e rëndësishme sesa ajo çka mendojnë ndërkombëtarët, jo se nuk ka rëndësi, por e rëndësishme për ndërtimin e shoqërisë është që të jenë shqiptarët ata që do ta bëjnë këtë dhe që vetë shqiptarët të besojnë tek njëri-tjetri sa më shumë që të munden. Një fushë ku mund të ndërtohet besimi apo një mundësi është bërja e gjërave së bashku, si për shembull të qenit së bashku në komisionet zgjedhore në ditën e zgjedhjeve dhe përgatitjet për ditën e zgjedhjeve. Partneriteti mes palëve është gjithashtu i rëndësishëm edhe gjatë procesit të numërimit. Unë isha disa herë i pranishëm në qendrat e votimit dhe ishte gjë e mirë të shihje komisionerët të ulur në një tavolinë, që vinin nga parti të ndryshme e që nuk dukeshin të tensionuar. Ata flisnin me njëri-tjetrin, e respektonin njëri-tjetrin dhe unë pata përshtypjen se ata po bënin më të mirën e tyre dhe kjo ishte gjë e mirë.

Pyetje: Kështu ndodh në nivelet e ulëta, por në nivelet më të larta ka një mungesë besimi. E keni ndeshur ju këtë?

Gjëja më e rëndësishme për një vend është populli i tij, kështu që ky është lajmi më i mirë që mund të ofrojë Shqipëria. Shqiptarët janë njerëz të mrekullueshëm dhe ata duhet t'i bëjnë udhëheqësit e tyre të kuptojnë e të respektojnë të njëjtin nivel civilizimi.

Pyetje: Po, sigurisht, por detyra e qytetarit mbaron në momentin që ai hedh votën. Më pas janë udhëheqësit ata që vendosin.

E drejtë, por ka edhe zgjedhje të tjera dhe janë njerëzit ata që vendosin se kujt duan t'ia japin besimin. Nuk ka asnjë garanci e madje nuk është as nevoja që njerëzit të votojnë gjithmonë njësoj. Politikanëve do t'u pëlqente që publiku të zgjidhte gjithmonë të njëjtën ngjyrë, por kjo është një garë. Është një garë për besim. Për të ardhmen. Kjo është ndoshta gjëja më e rëndësishme. Dhe kështu duhet të funksionojë në Shqipëri. Kjo u pa në Tiranë, në garën për kryetar bashkie. Rezultati ishte kaq i ngushtë, sa që nuk ka rëndësi se çfarë të dhënash merr, ato të mbrëmshmet apo ato të sotmet. Ishin kaq afër. Ishin kaq afër sa treguan se çdo votë vlen. Gara tregoi se mund ta kishte fituar qoftë njëra, qoftë tjetra palë. Nuk mund të kishte qenë më dramatike se aq.

Pyetje: A do të kishit një koment për aktivitetin e KQZ-së gjatë përgatitjeve të zgjedhjeve lokale të 8 majit, si për ditën e zgjedhjeve, ashtu edhe për ditët pas tyre? Le të fillojmë me përgatitjet. Si ishte performanca e KQZ-së?

Puna e KQZ-së ka qenë sigurisht shumë intensive dhe komplekse. Ata duhet të jepnin udhëzime dhe këshilla për krijimin e komisioneve të zonave për administrimin e zgjedhjeve dhe duhet ta bënin këtë brenda disa afateve të shkurtra para ditës së zgjedhjeve. Partitë politike nuk bashkëpunuan plotësisht për t'u përgjigjur në kohën e duhur, dhe kjo e bëri punën e KQZ-së më të vështirë në disa momente sa i përket marrjes së vendimeve dhe shtypjes së fletëve të votimit të kohën e duhur. Por thënë kjo, unë përmenda vetëm disa detaje, përveç faktit që performanca e tyre ishte mjaft e mirë gjatë punës përgatitore komplekse në mënyrë që të gjithë njerëzit të kishin mundësi të votonin. Në këto zgjedhje pati 2 x 384 procese votimi për kryetarë bashkie dhe

komune dhe për këshilla bashkie dhe komune – një detyrë jashtëzakonisht e madhe dhe komplekse.

Pyetje: A ka të bëjë fakti që pati shumë vota të hedhura në kuti të ndryshme që nuk ishin për kandidatin me performancën e KQZ-së sa i përket edukimit dhe informimit të qytetarëve për mënyrën e votimit?

Sigurisht, është njerëzore të bëhen gabime. Është një thënie latine “*errare humanum est*” (“të gabosh është njerëzore”), pra kjo mund të ndodhë. Zakonisht në çdo qendër votimi kishte dy kuti votimi, kurse në Tiranë kishte katër. Ngjyrat nuk ishin shumë të ndryshme dhe kështu që mund të ndodhnin gabime. Shumica e votave ishin hedhur në kutitë e duhura dhe numri i votave të hedhura jo në kutitë e duhura ishte i vogël. Sigurisht që ka një shqetësim të madh në lidhje me çfarë ndodh me votat e hedhura jo në kutitë përkatëse dhe se cila është situata ligjore për këtë çështje. Megjithatë nuk do të komentoja mbi vendimmarrjen e KQZ-së, mendoj se është e rëndësishme që votat të numërohen në mënyrë objektive. Unë besoj se i tillë ka qenë procesi i numërimit. Ai ishte në një masë të madhe i përgatitur mirë, por të dyja palët ishin jashtëzakonisht afër dhe çdo gjë duhet të trajtohej me kujdesin më të madh dhe në përputhje të plotë me shtetin e së drejtës. Kështu që do të shohim patjetër më shumë analiza për këtë dhe unë besoj se kjo është shumë e rëndësishme.

Pyetje: A ishin juristët dhe ekspertët e OSBE-së në dijeni të akteve normative të miratuara nga KQZ-ja me 4 vota pro dhe 3 kundër për hapjen e votave të kontestuara?

Ne po e ndiqnim procesin. Misioni i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve ishte ai që e ndoqi më nga afër. Për ne ishte shumë e rëndësishme që të kishim një përshtypje të dorës së parë në planin afatgjatë dhe të shihnim se si u përgatitën dhe si u menaxhuan zgjedhjet më pas. Në mbledhjet e KQZ-së kanë qenë rregullisht të pranishëm anëtarë të stafit tim. Ata kanë njohuri të mira dhe më kanë ofruar këshilla mua dhe ekipit tim për mënyrën se si duhet t'i formulojmë propozimet tona për reformën zgjedhore për të pasur zgjedhje edhe më të mira.

Pyetje: A ishte legjitim akti i KQZ-së?

Kjo pyetje i duhet bërë palës shqiptare. E rëndësishme për ne është që të numërohen të gjitha votat dhe të zbatohet i njëjti standard në trajtimin e votave të hedhura jo në kutinë përkatëse. Ka ndodhur apo nuk ka ndodhur kështu, kjo është diçka për t'u analizuar.

Pyetje: A mendoni se KQZ-ja duhet t'i kishte shpallur rezultatet paraprake për Tiranën të shtunën kur mbaroi numërimi, apo kjo nuk është e detyrueshme?

Varet se si e lexon Kodin Zgjedhor. Perceptimi i publikut ishte ai që ishte, media raportoi atë ditë dhe kjo është një çështje e rëndësishme. Publiku pret që ta marrë vesh, kështu që në fund të numërimit duhet të ketë një rezultat paraprak. Kodi Zgjedhor nuk e parashikon saktësisht kështu. Ndoshta kishte arsye të mira për zgjatjen e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, por unë do të kisha sugjeruar që të kishte një prononcim publik për të bërë të ditur se si ishte gjendja.

Pyetje: Çfarë mendoni për vendimin e djeshëm të KQZ-së dhe si mendoni se e sheh atë opozita?

Kjo do të këqyret me kujdes me siguri nga ekspertët ligjorë dhe Kolegji Zgjedhor, kështu që nuk do të doja të bëja ndonjë koment. Gjykime të tilla duhet të bëhen nga ekspertët shqiptarë që kanë aftësinë për ta bërë këtë.

Pyetje: A jeni në dijeni të ndonjë rasti tjetër ku KQZ-ja ka vepruar njësoj me votat e hedhura në kutitë e gabuara, apo mund të themi se KQZ-ja përdori atë që tashmë njihet si standardi i dyfishtë në Tiranë?

Unë e kam parë raportin e ODIHR-it dhe do të mundohem të mos bëj asnjë koment në këtë moment. ODIHR-i ka qenë i pranishëm dhe ne do ta kemi një tablo prej tyre, kështu që le të presim për raportin e tyre përfundimtar.

Pyetje: Çfarë mendoni për mospërputhjet e pretenduara nga opozita mes numrit të votave dhe numrit të votuesve? Flasin për rreth 870 vota më shumë sesa numri i votuesve.

Kjo është sigurisht një çështje për të cilën mund të shqetësohemi. Nëse ka mospërputhje, kjo duhet parë me kujdes, dhe duhet të ketë një shpjegim për një diferencë të tillë.

Pyetje: Opozita pretendon gjithashtu se është vënë dorë në kutitë e votimit. A e kanë edhe ekspertët tuaj një shqetësim të tillë?

Mesa di unë, si procesi, ashtu edhe transporti janë vëzhguar. Megjithatë, kjo duhet parë me kujdes. Pra, është e pamundur që të bëj komente. Unë jam njohur me situatën dhe i kuptoj shqetësimet, por mendoj se ju keni institucione që do ta analizojnë situatën. Dua të përsëris së gara ishte kaq e ngushtë saqë çdo hap duhet analizuar me kujdes. Megjithatë, ngritja e një pyetjeje të tillë është legjitime.

Pyetje: A mendoni se ka pasur prapaskena politike në vendimet e KQZ-së?

Sigurisht që ka pasur komente nga jashtë KQZ-së mbi punën e saj. Por puna e saj është thjesht teknike, mbështetje teknike për votuesit që ata të kenë mundësi të votojnë. Duke pasur parasysh situatën, ngërçin në parlament, situata u politizua, pavarësisht se ne nuk do të donim që të ishte.

Pyetje: Cila nga palët politike pati më shumë influencë në KQZ?

Ka dy anë në KQZ dhe do të ishte e vështirë të thosha se kush nuk u përpoq të kishte influencë.

Pyetje: Unë personalisht mendoj se e vërteta nuk mund të ketë dy anë. A ndani edhe ju të njëjtin mendim?

Megjithëse ka vetëm një KQZ, disa anëtarë janë të emëruar nga shumica, kurse disa të tjerë nga opozita, pra ka dy anë. Në njëfarë mënyre është mirë që ta kemi bashkëpunimin mes tyre bazuar tek vullneti i mirë. Është e nevojshme që të kemi pikëpamje të drejta për atë çka ndodh aty nga të dyja palët. Por elementi kyç është që të gjithë, jo vetëm unë, dëshirojnë më shumë.

Pyetje: Ju keni qenë mjaft aktiv së bashku me Ambasadorin amerikan dhe Ambasadorin e BE-së në atë çka në media tashmë njihet si *Troika e Ambasadorëve* në takimet tuaja me autoritetet dhe me politikanët shqiptarë. Do të doja t'ju pyesja nëse ka ndonjë dallim mes ambasadorëve në mënyrën se si secili prej jush i sheh çështje të caktuara?

Jo, jo sa i përket çështjeve politike *thelbësore*. Unë sigurisht përfaqësoj një organizatë jo aq të lehtë për t'u kuptuar. Është një organizatë që punon për demokratizimin, të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës, kurse Ambasador Arvizu përfaqëson në komb të madh siç janë Shtetet e Bashkuara me një skemë detyrash të tjera si tregtia e kështu me radhë. Detyra e Ambasadorit të BE-së Sequi është sigurisht më e gjerë sesa e imja. Detyra jonë si OSBE është themelore sa i përket përpjekjes për vlerat themelore që çojnë në më shumë integrim qoftë në fushën e mbrojtjes, në fushën tregtare, apo në nivel rajonal. Në këtë aspekt nevojitet një mirëkuptim i përbashkët për ta bërë demokracinë edhe më të qëndrueshme. Neve na rreh zemra njësoj kur bëhet fjalë për parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës. Ne jemi absolutisht në një linjë kur vjen fjala tek domosdoshmëria për shtetin e së drejtës apo tek çështje të tjera pas-zgjedhore. Pra, kemi shumë gjëra të përbashkëta, ndonëse detyrat tona nuk janë plotësisht identike. Është gjë shumë e mirë që ne mund ta bëjmë këtë bashkërisht për të mbështetur vendin.

Pyetje: Si ka mundësi që ambasadorët shkonin gjithmonë në ato qendra numërimi ku kishte probleme, si për shembull tek qendra e numërimit për njësinë 5, e cila u kthye në një qendër legjendë në Tiranë. A ju merrnin në telefon partitë politike apo ekspertët tuaj? Dhe sa herë që ju shfaqeshit, gjithçka rregullohej si me mrekulli, gjithçka zhblllokohej.

Edhe ne kemi televizorët tanë për t'u informuar. Nuk është se ulemi në zyrë e presim çfarë do të ndodhë. Ne përpiqemi të marrim informacion të dorës së parë duke treguar edhe solidaritet me ata që numëronin. Unë mendoj se numëruesit kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe e me shume energji dhe për ne ishte sigurisht emocionuese mënyra se si punonin, atmosfera ku punonin dhe sa ditë iu desh për ta bërë këtë siç duhet, ndonjëherë edhe mes një zhurme të madhe.

Pyetje: Për çfarë keni diskutuar bashkë me ambasadorët e tjerë në takimin me Kryeministrin Berisha, Z. Rama dhe me Presidentin? Çfarë qëndrimi u keni kërkuar ju si OSBE që të mbajnë?

Së pari më lejoni të them që personalisht kam marrëdhënie shumë të mira pune me të tre, dhe kjo është shumë e rëndësishme jo vetëm për udhëheqësit por edhe për mbështetësit. Shqetësimi i këtyre ditëve të fundit, shqetësimi kryesor, është shteti ligjor, dhe nuk është diçka e lehtë nëse marrim parasysh faktin që Kodi Zgjedhor nuk rregullon çdo aspekt. Kështu që i takon palës shqiptare të bëjë sqarimet dhe të arrijë në konsensusin e nevojshëm për të hapur rrugën e mirëkuptimit – veçanërisht në parlament – në lidhje me axhendën e integritimit evropian. Një aspekt tjetër është ruajtja e qetësisë, që do të thotë se është shumë e rëndësishme të theksohet që situata duhet të mbetet e qetë, që çdo gjë të zgjidhet duke diskutuar në mënyrë të qytetëruar, duke trajtuar pikat ligjore dhe duke arritur një përfundim të kënaqshëm për të gjithë. Sigurisht që kjo mund të arrihet vetëm në rrugë paqësore.

Pyetje: Z. Ambasador, në media dhe në shoqërinë shqiptare ekziston perceptimi që ambasadorët bien dakord me secilin nga politikanët që takojnë. Është e vërtetë?

Ne nuk jemi këtu për të goditur njerëzit. Kjo është shumë e rëndësishme. Nuk është e mundur të jemi dakord me çdo gjë, dhe partnerët tanë kombëtar e dinë. Ndonjëherë vërejmë që pozicionet tona nuk përputhen, por asnjëherë, nga asnjëra palë, nuk ka pasur kundërshtime kur bëhet fjalë për shtetin e së drejtës. Megjithatë, është shumë e qartë që në disa raste, madje në disa raste të rëndësishme, interpretimet nuk janë të njëjta, por kjo është çështje ligjore dhe duhet zgjidhur në mënyrën e duhur, jo në rrugë, apo nëpërmjet diskutimeve të ashpra, por nga ekspertët përkatës dhe me argumente ligjor. Jam i sigurt që kjo do të jetë e mundur edhe në Shqipëri.

Pyetje: Pra, ju ua keni shprehur mendimin tuaj politikanëve shqiptarë. Si kanë reaguar?

Kanë dëgjuar me kujdes, sepse janë të interesuar të gjejnë një zgjidhjen e duhur që do të shtrojë rrugën drejt së ardhmes.

Pyetje: Kohët e fundit jeni takuar edhe me kryetarin e KQZ-së, Z. Ristani. Keni shprehur ndonjë shqetësim për punën e KQZ-së këto ditët e fundit të procesit të numërimit? Çfarë keni diskutuar me të?

Nuk e kam takuar gjatë procesit të numërimit. Përpara zgjedhjeve jemi takuar rregullisht, por jo gjatë numërimit sepse kjo është një çështje teknike dhe nuk ka nevojë për ndërhyrje, as në këto ditët e fundit. KQZ-ja është duke bërë rolin e një KZAZ-je, dhe nuk e kam parë të arsyeshme të ndërhyj. Kontaktet në këtë drejtim janë mbajtur nga Kryetari i Misionit të Vëzhguesve Zgjedhor, Jonathan Stonestreet.

Pyetje: Si e shpjgoni faktin që Shqipëria mbetet ende pas për sa i përket pjekurisë së institucioneve për të zgjidhur vetë problemet, brenda tyre, duke kërkuar edhe ndërhyrjen e ndërkombëtarëve? Si e shpjgoni këtë mungesë?

Nuk është e lehtë për t'u përgjigjur, sepse është e vërtetë nga ana tjetër që në Shqipëri ka njerëz të talentuar dhe racional. Ndoshta nuk janë të guximshëm aq sa duhet. Ne do të donim të shihnim një shoqëri civile të fortë, jo vetëm në diskutimet politike por edhe në fusha të tjera si për shembull në arsim. Por në këtë fazë ne mund të ofrojmë ndihmën tonë, prandaj jemi këtu. Megjithatë, do të ishte shumë më mirë që zgjidhjet të gjendeshin nga shoqëria shqiptare.

Pyetje: Mendoni se do të ndodhë në të ardhmen e afërt?

Mund të them që ka progres. Për shembull 'Forumi Civil 2010' i ish presidentëve Moisiu dhe Meidani, dhe shumë personaliteteve të tjera, ka nxjerrë ide shumë të mira. Është një tendencë inkurajuese, kështu që kjo është shenjë përmirësimi.

Pyetje: Mendoni se Kolegji Zgjedhor gëzon nivelin e duhur të besueshmërisë për të marrë një vendim të ligjshëm që në fund do të respektohet nga të gjitha partitë politike në Shqipëri?

Jam i sigurt se po. Gjyqtarët janë profesionist. Nuk shoh arsye pse të mos ndodhë. Pres që njerëzit, duke përfshirë edhe partitë politike, të kenë besim se konkluzionet do të jenë të analizuara dhe në fund rezultatet të jenë të pranueshme. Po i kthehem këtu një pike që përmenda më lart: nuk kemi ende rezultatet përfundimtare. Ka dalë një rezultat paraprak dhe tani po fillon periudha e ankimeve, kështu që vetëm në fund të kësaj periudhe do të kemi rezultatin përfundimtar. Pasi kjo të zgjidhet, mund të flasim për rezultatin përfundimtar që duhet të presin partitë politike.

Pyetje: Besoj se jeni në dijeni të mungesës së thellë të besimit në sistemin ligjor në Shqipëri. Tashmë ekzistojnë të ashtuquajturat 'standarde të dyfishta'. Z. Ambasador, si Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, a do të inkurajoni Kolegjin Zgjedhor të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të painfluencuar?

Sigurisht që po! Ata duhet të zbatojnë të gjithë rregullat, duke filluar që nga Kushtetuta, sigurisht edhe Kodin Zgjedhor; të analizojnë vendimet e marra nga KQZ-ja dhe bazën e këtyre vendimeve. Është një detyrë e madhe, komplekse, dhe besoj që jo vetëm janë të gatshëm për të marrë një vendim të tillë, por edhe që janë të aftë për këtë. Të përpiqemi të mos krijojmë shumë zhurmë duke komentuar në lidhje me gjyqtarët. Pavarësia e gjyqtarëve është një çështje e rëndësishme në një shoqëri.

Pyetje: Z. Ambasador, a ishte procesi zgjedhor i 8 majit më i mirë në krahasim me proceset e tjera në të kaluarën? A ka bërë Shqipëria ndonjë hap përpara, ka mbetur ende në vend, apo ka bërë hapa prapa?

Po fokusohem te dita e zgjedhjeve. Perceptimi im personal ishte ai i një dite të mirë – pashë pjesëmarrje të gjerë, qytetarët në të gjithë vendin mund të hidhnin votën e tyre; kishin mundësi zgjedhjeje, dhe bënë një zgjedhje. Vura re që përgatitjet teknike ishin të mira dhe dita e zgjedhjeve ishte një ditë e mirë për demokracinë. Por meqë përshtypja ime për këtë ditë ishte një perceptim jo shkencor, këtë pjesë po ia lëmë ODIHR-it.

Pyetje: Shqetësimet nuk lidhen me ditën e zgjedhjeve, por me atë që ndodhi më pas, d.m.th me numërimin dhe administrimin e votave.

Mendoj se më i rëndësishëm është fakti që njerëzit në mbarë vendin janë më të interesuar të votojnë, dhe pjesëmarrja ishte e lartë, më e lartë se ç'pritej për zgjedhjet vendore. Kjo është shenjë e mirë që tregon se njerëzit kanë interes se kush do të drejtojë qytetet, fshatrat, bashkitë e tyre. Mendoj se kjo tregon një shkallë të lartë interesi. Megjithatë, njerëzit, votuesit e të gjitha moshave kanë edhe preokupime të tjera në jetë. Për këtë arsye politikanët duhet të marrin përgjegjësitë dhe të ofrojnë shërbimet e nevojshme lokale. Duhet menduar për qytetarët, që pas

zgjedhjeve të arrijnë të kenë besim se sistemi që gjendej në kutitë e votimit do të gjejë një zgjidhje, dhe besim që personat e zgjedhur do të ofrojnë shërbimet e duhura. Përndryshe, nëse njerëzit nuk kanë besim tek ata që zgjedhin do të vazhdonim të kishim zgjedhje pa fund.

Pyetje: Z. Ambasador, në Shqipëri vota administrohet nga mbështetësit e partive. A përbën kjo dështim të shtetit të së drejtës në interes të partive politike?

Jo, nuk ka probleme me mbështetësit e partive dhe mënyrën sesi veprojnë. Mund të jesh mbështetës i një partie dhe të bësh këtë gjë në mënyrën e duhur – në mënyrë të balancuar. Në qoftë se nuk gabohe, kjo është vënë re edhe në qendrat e numërimit. Kështu që, të tregohem i sigurtë, nuk shoh ndonjë problem me administrimin. Në shumicën e rasteve njerëzit janë treguar të qytetëruar.

Pyetje: A mendoni se ndërkombëtarët i kanë bekuar (miratuar) në njëfarë mënyrë ndryshimet kushtetuese të bëra nga dy drejtuesit e vendit, Berisha dhe Rama, para dy vitesh?

Edhe pse është komentuar gjerësisht që kjo mund të jetë e vërtetë, më lejoni t'ju them me modesti se nuk duhet mbivlerësuar. Kontributet më të rëndësishme erdhën nga shqiptarët. Kontributi më i madh erdhi nga ata që votuan, nga ata që i shërbyen vendit në komisionet e zonave administrative në mbarë vendin, në 66 qendrat e numërimit, duke numëruar ditë e natë e ndonjëherë jo në kushte të lehta pune. Dhe gjithçka shkoi mjaft mirë. Ndoshta në të ardhmen politikanët mund të vendosin ta bëjnë më të lehtë procesin e numërimit – duke qenë më i decentralizuar. Por kjo varet edhe nga rekomandimet në raportin përfundimtar të ODIHR-it.

Pyetje: Në fakt pyetja e radhës është pikërisht për rekomandimet e mundshme të ODIHR-it në lidhje me përdorimin e metodave elektronike dhe automatike të numërimit si për shembull skanera optik, apo kabina votimi, për ta bërë votimin edhe më të shpejtë. Mendoni se është sugjerim i dobishëm për Shqipërinë?

Në tablonë globale të demokracisë përfshihen të gjitha këto metoda. Kjo varet se për cilën metodë bie dakord një shoqëri e caktuar. Mund të përdoret secila mënyrë që duket më e përshtatshme për qytetarët shqiptarë. Mua më pëlqen mënyra tradicionale – një fletë ku mund të vendosësh një kryq (X) sepse do të thotë që ke diçka konkrete në dorë të cilën e hedh në kuti, jo thjesht duke shtypur një buton. Por ka edhe njerëz që preferojnë të shtypin një buton për të votuar, avantazhi i së cilës është se nuk ka një sasi të madhe votash që duhen numëruar më pas. Pra, është çështje preference, nuk ka vetëm një mënyrë votimi.

Pyetje: Ndoshta një mënyrë më e shpejt votimi do të sillte edhe rezultatet më shpejt, d.m.th brenda disa orëve, dhe jo pas disa ditëve; për të mos përmendur këtu mungesën e besimit midis partive dhe mos-pranimin e rezultatit në fund.

Mund të jetë e vërtetë.

Pyetje: Si e sheh OSBE-ja mbulimin e këtyre zgjedhjeve nga media shqiptare?

Ishte një mbulim mbresëlënës. Së pari, më kujtohet kur po udhëtoja me makinë duke dëgjuar radion ku po komentohej numërimi, e të linte përshtypjen e një ndeshje futbolli sepse dëgjohej numërimi Basha-Rama, Basha-Rama, Basha-Rama. Apo si një ndeshje tenisi kur shtohet komenti për votat e pavlefshme. Të gjithë e dinin që rezultati ishte i ngushtë, ishte një garë që deri në momentin e fundit nuk ishte e qartë se kush do ta kalonte i pari vijën e finishit. Ishte një pritje që të mbante në tension dhe mendoj se media ka bërë punë të mrekullueshme për të ofruar një proces transparent dhe më interesant për njerëzit, duke ofruar një plan të parë të procesit. Është vërtet e rëndësishme që çdo votë të numërohet, prandaj duhet të ketë një proces numërimi të saktë dhe të pajtueshëm.

Pyetje: Opozita mendon se është matematikisht dhe statistikisht e pamundur që rezultati në fund të ishte 50:50 dhe 70:30 në favor të Bashës për kutitë e hapura nga KQZ-ja për të numëruar votat e kontestuara. Cili është mendimi juaj?

Kam parë publikime në lidhje me këtë. Mendoj se duhet të pyesim statisticienët, por shumë prej tyre do të kishin opinione të ndryshme. Zakonisht mund të jetë opinion më i saktë kur bëhet fjalë për shifra të mëdha mbi 1000. Për një shifër më të ulët, për shembull 700, lëkundjet janë më të larta. Unë jam inxhinier dhe ekonomist, dhe kam studiuar edhe statistikë, ndaj edhe disa gjëra në dukje të pamundura në të vërtetë janë të mundura; është interesante të diskutosh në lidhje me statistikat. Por ajo që nevojitet është një analizë e kujdesshme sesi është kryer procesi, si është bërë numërimi, nëse përpunohen shifrat, etj.

Pyetje: Cili është komenti juaj në lidhje me balancën e arritur nga Ora News në mbulimin e zgjedhjeve?

Ka qenë një punë e shkëlqyer. Është gazetari profesionale dhe një shenjë e mirë drejtësie. Kushdo mund të pyesë nëse ka qenë një minutazh i barabartë për të dy ngjyrat politike. Me shumë mundësi po. E rëndësishme është që partive politike, protagonistëve dhe kandidatëve, t'u jepet mundësia të informojnë votuesit në lidhje me qëndrimet, premtimet dhe programet që ofrojnë. Kjo është e rëndësishme për qytetarët që të vendosin se kë të votojnë.

Pyetje: Televizioni Ora News ishte i parë që refuzoi transmetimin e kasetave të gatshme për hir të standardeve profesionale dhe lirisë së medias.

Është shumë e rëndësishme që gazetarët të kenë energjinë e duhur për këtë dhe qasje të drejtpërdrejtë – që të shkojnë aty ku ndodh lajmi, të intervistojnë aktorët kryesorë, të jenë të pranishëm atje ku mbahen fjalimet që të shohin çfarë ndodh dhe ndonjëherë të shtojnë komentet e tyre. Është e rëndësishme për gazetarinë të mos mbështet te kasetat e regjistruara nga partitë politike. Këto kasetat do të shërbenin si reklama, por ky është një kapitull tjetër. Edhe pse mund të ishin të dobishme, nuk mund të quhen gazetar.

Pyetje: Kompanitë serioze të pyetësorëve dhe anketimeve (exit polls) refuzuan të bëjnë këtë gjë këtë vit për shkak të nivelit të lartë të refuzimit nga të intervistuarit. A janë këto pyetësorë dhe anketime (exit polls) të besueshme?

Për ne nuk është dhe aq e rëndësishme se kush fiton. Për ne është e rëndësishme që procesi të jetë i drejtë dhe që çdo kandidat të ketë mundësinë të diskutojë, dhe që votat të numërohen. Të vetmit që vendosin janë qytetarët – si për kryetarët e bashkive dhe për këshillat. Nuk i takon ndërkombëtarëve dhe as që e mendojmë një gjë e tillë. Për ne është shumë e rëndësishme që kushtet të jenë të barabarta për të gjithë.

Q. Transparenca e financimit të partive politike ka qenë një nga shqetësimet e ngritura nga ODIHR-i për zgjedhjet e vitit 2009. Është normale që KQZ-ja të vendosë transparencën e partive politike?

Në çdo vend është e nevojshme të ketë një rregullim të financimit të partive politike. Do ishte shumë mirë nëse vendosej niveli më i lartë i mundshëm i transparencës. Megjithatë, edhe në vendin tim ka sfida. Partitë politike duhet të jenë transparente, por kjo nuk është gjithmonë e lehtë për shkak të donacioneve – ka disa njerëz që mund të krijojnë influenca legjitime për sa kohë që qëndrojnë transparente. Ky është elementi kryesor i demokracisë. Është e rëndësishme të dimë se kujt t'i besojmë. KQZ-ja është organ teknik, me një buxhet të caktuar dhe me shpenzime, dhe buxheti i tyre është transparent.

Pyetje: Kanë kaluar dy vjet që nga zgjedhjet e vitit 2009 dhe rekomandimet e ODIHR-it nuk janë trajtuar ende nga partitë politike. A ka kuptim që të dalin rekomandime të tjera ndërkohë që klima politike është përkeqësuar më tej?

Mendoj se ka kuptim. Zgjedhjet e vitit 2011 ishin zgjedhje vendore, dhe një nga vëzhgimet paraprake që kemi bërë, edhe para ditës së zgjedhjeve, madje edhe para se të vinte ODIHR-i, është që pjesa më e madhe e Kodit Zgjedhor trajton çështje në lidhje me zgjedhjet parlamentare, dhe nuk përmban një kapitull të posaçëm për zgjedhjet vendore. Kjo është një fushë ku duhet punuar. Pritet që raporti përfundimtar i ODIHR-it të trajtojë këtë çështje dhe të japë disa rekomandime.

Pyetje: A ishin zgjedhjet e majit të drejta dhe të lira, dhe në përputhje me standardet e OSBE/ODIHR-it?

Kësaj pyetje do t'i japë përgjigje raporti përfundimtar i ODIHR-it, i cili zakonisht del dy muaj pas largimit të misionit.